



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 7003/2461/421

Nr. Vendimit 155

Data e rregjistrimit 10.09.2014

Data e vendimit 04.02.2016

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

|                    |           |
|--------------------|-----------|
| Lindita SINANAJ    | Kryesuese |
| Artur MALAJ        | Anëtar    |
| Alkelina GAZIDEDJA | Anëtare   |

me sekretare gjyqësore *Visela Kashari*, në Tiranë, sot në datë 04.02.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

**PADITËS:** *Edmond Rrapaj*, i biri i Nekiut dhe i Hatemes, i datëlindjes 24.08.1976, lindur në Ballsh dhe banues në Fier.

**TE PADITUR:** -*Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.*  
-*Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë.*

**OBJEKTI:** Anullimi i Njoftimit të Vlerësimit Tatimor nr. 5814, date 20.04.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, si dhe Vendimit nr. 8736/3, datë 18.05.2012 të

Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë për vendosjen dhe lënien në fuqi të gjobës në masën 100.000 lekë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 32, 153, 324, 331 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile, neni 109/2 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

pasi dëgjoji relacionin e kryesueses së trupit gjykues, shqyrtoi pretendimet e parashtruara në ankim nga pala paditëse Edmond Rrapaj, që kërkon:

*-ndryshimin e vendimit nr. 5358/(1752), datë 20.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pranimin e kërkesë padisë.*

dhe bisedoi çështjen në tërësi:

### **VËREN**

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 10.09.2014, është rregjistruar ankimi i paraqitur nga pala paditëse Edmond Rrapaj, kundër vendimit nr. 5358/(1752), datë 20.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në nenet 442, 443 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 48 të ligjit nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”. Ky ankim fillimisht është rregjistruar në Gjykatën e Apelit Vlorë në datën 29.01.2013. Kjo gjykatë me vendimin nr. 701, datë 22.04.2014 ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje duke dërguar aktet në Gjykatën Administrative të Apelit për shkak të fillimit të funksionimit të Gjykatave Administrative në datën 04.11.2013, si dhe referuar Vendimit Unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 08.06.2012, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është rregjistruar padia objekt gjykimi. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.5358/(1752), datë 20.09.2012, ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve në Gjykatën e Apelit Vlorë duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit”*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala e paditëse Edmond Rrapaj, duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Vendimi i gjykatës është i padrejtë, i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë duhet të ndryshohet duke u vendosur pranimi i kërkesë padisë.
- ✓ Nga ana e paditësit ishte aplikuar që prej datës 30.03.2012 për pajisjen dhe kalimin në pronësi të tij të kasës fiskale nr.IV0000979, pas c`regjistrimit të saj nga shoqëria “Global Logistic”, me të cilën paditësi ka lidhur një kontratë qeraje për një automjet transporti.
- ✓ Për shitjet e kryera subjekti tatimpagues Edmond Rrapaj, palë paditëse në gjykim, ka operuar me fatura dhe dëftesa tatimore deri në kalimin në pronësi të kasës fiskale.
- ✓ Në momentin e ushtrimit të kontrollit nga ana e organeve tatimore, subjekti tatimpagues nuk po kryente veprime shitjeje.
- ✓ Fakti që në procesverbalin e mbajtur në terren nuk është evidentuar ora e kontrollit apo ajo e kryerjes së veprimeve të shitjes, nënkupton që pretendimi se subjekti tatimpagues po ushtronte aktivitet tregtar është i pabazuar.
- ✓ Procesverbali nr. 0078439, datë 05.04.2012 nuk është i besueshëm, për faktin se ai nuk shprehet lidhur me llojin e mallit të shitur, vendin konkret dhe orën e shitjes, vërtetimin e procesverbalit me anë të dëshmitarëve të pranishëm apo theksimin e faktit se në momentin e procedimit nuk kanë qënë të pranishëm dëshmitarë, në zbatim të nenit 80 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* dhe pikës 80/c dhe 81 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*.
- ✓ Procedimi administrativ nuk mund të konsiderohet i rregullt, sepse subjektit të kontrollit të ushtruar nuk i është krijuar mundësia për të marrë pjesë personalisht në të.

- ✓ Në rastin konkret, pala e paditur nuk ka respektuar të drejtën e paditësit për t'u dëgjuar, e po ashtu nuk ka respektuar parimet kryesore të procedimit tatimor apo administrativ, si parimi i procesit të rregullt ligjor, i mbrojtjes së interesit publik, i mbrojtjes së interesave kushtetuese e ligjore të qytetarëve, si dhe parimin e ligjshmërisë.
- ✓ Në të kundërt nga sa është argumentuar nga gjykata e shkallës së parë, në kërkesëpadi paditësi ka parashtruar pretendime që lidhen me veprime absolutisht dhe relativisht të pavlefshme dhe është detyrë e gjykatës që konform nenit 331 të Kodit të Procedurës Civile të shprehet lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre.

*Për sa më sipër ankuesi ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 5358/(1752), datë 20.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pranimin e kërkesë padisë.*

#### *Rrethanat faktike të çështjes*

Paditësi Edmond Rrapaj është regjistruar në datën 17.03.2011 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person fizik dhe ka si objekt të veprimtarisë së tij tregtinë e artikujve industrialë të ndryshëm e të përzier. Në datën 05.04.2012 nga ana e inspektorëve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier është ushtruar kontroll, gjatë të cilit është mbajtur akt konstatimi nr. 0249401, nga përmbajtja e të cilit konstatohet se subjekti tatimpagues Edmond Rrapaj, palë paditëse në gjykim, nuk ka qënë i pajisur me kasë fiskale dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar faktin që dispononte kasë fiskale. Mbi bazën e këtij akti konstatimi, nga ana e inspektorëve të organit tatimor është mbajtur procesverbali i gjobës nr.0078439, datë 05.04.2012, me të cilin pala e paditur ka vendosur të dënojë tatimpaguesin me gjobë në shumën 100.000 lekë, bazuar në nenin 122, pika 1/a, gërma "i" të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*".

Në vijim të sa më sipër, pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka nxjerrë Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 5814 prot., datë 20.04.2012, drejtuar paditësit Edmond Rrapaj, ku është evidentuar detyrimi i këtij të fundit për të paguar gjobën në shumën 100.000 lekë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 8736/3 prot, datë 18.05.2012 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pas rekursit administrativ të

ushtruar nga paditësi, me të cilin ka kërkuar anulimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. 5814 prot., datë 20.04.2012. Në këto kushte paditësi Edmond Rrapaj i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë padi, duke kërkuar prej saj anulimin e akteve administrative objekt gjykimi, kërkesë padi e cila është vlerësuar e pabazuar në ligj dhe në prova, e për këtë arsye është disponuar me vendim për rrëzimin e saj.

Në analizë të rrethanave të faktit dhe të ligjit që lidhen me çështjen objekt gjykimi, gjykata ka arsyetuar se vendimmarrja e palës së paditur është e bazuar në ligjin e posacëm e për këtë arsye duhet të lihet në fuqi. Konkretisht akti administrativ objekt gjykimi është nxjerrë në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 122, pika 1, gërma "a" të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007 "*Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale*", në të cilat është përcaktuar në mënyrë të shprehur detyrimi i tatimpaguesit për instalimin e përdorimin e pajisjeve fiskale dhe dënimin e tij me gjobë në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata ka argumentuar se paditësi nuk ka arritur të provojë pretendimin se detyrimi tatimor i vendosur ndaj tij është i pabazuar, detyrim të cilin e kishtë në bazë të nenit 108, pika 5 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", ku është parashikuar se barra e provës për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë bie mbi tatimpaguesin Gjithashtu paditësi ka qënë kontradiktor në paraqitjen e pretendimeve të tij, për shkak se nga njëra anë ka pretenduar se në castin e kontrollit nuk ka ushtruar aktivitet tregtar, ndërsa nga ana tjetër ka ngritur pretendimin se për shitjet e kryera ka lëshuar fatura dhe dëftesa tatimore.

Paditësi ka pretenduar se procedimi administrativ është i parregullt për shkak se refuzimi i nënshkrimit nga Gëzim Kovaci në procesverbalin e gjobës nr.0078439, datë 05.04.2012 nuk është vërtetuar nga dëshmitarë të pranishëm në vendin e ngjarjes, në zbatim të neneve 13 dhe 14 të ligjit nr.10297, datë 20.05.2010 "*Për Kundravajtjet administrative*", por ky pretendim është

vlerësuar si i pabazuar nga ana e gjykatës, me argumentimin se referenca në ligjin për kundërvajtjet administrative është e gabuar, për sa kohë që mosmarrëveshja objekt gjykimi rregullohet nga ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Pretendimi i paditësit lidhur me faktin se akt konstatimi nr.0249401 i mbajtur në datën 05.04.2012 dhe procesverbali i gjobës nr.0078439, datë 05.04.2012 janë akte të njëanshme dhe të parregullt nga pikpamja formale dhe procedurale, është cmuar i pabazuar dhe i pambështetur në bazën juridike të padisë, për shkak se këto kërtime lidhen me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, në një kohë kur në kërkesë padi paditësi ka kërkuar anulimin e akteve administrative objekt gjykimi, kërkim i cili lidhet me pavlefshmërinë relative të këtyre akteve.

#### *Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit*

*Së pari* gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma “a”, nenit 10, paragrafi 2, gërma “a” dhe nenit 44 të ligjit nr.49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

*Së dyti* vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 20.09.2012, kurse ankimi nga pala paditëse Edmond Rrapaj, është paraqitur në datën 04.10.2012, pra dukshëm brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata cmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit nr. 5358/(1752), datë 20.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

*Së treti* lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim nga pala paditëse, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në këto pretendime rezultojnë të jenë paraqitur të njëjtat fakte dhe argumenta që janë paraqitur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe asnjë argument shtesë se përse analiza e rrethanave të faktit të bërë në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është e pabazuar në ligj e prova.

Konstatohet se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim u është dhënë zgjidhje me vendim nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit që janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analizë rezultojnë të jetë plotësisht e bazuar në kriteret e dispozitave përkatëse të përmendura në vendim, lidhur me përcaktimin e saktë të kundravajtjes administrative të konsumuar nga pala paditëse, subjekti tatimpagues Edmond Rrapaj.

Në analizë të akteve e provave shkresore të administruara në gjykim, si dhe të rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata Administrative e Apelit, në përputhje edhe me konkluzionin e arritur nga gjykata e shkallës së parë, cmon se vendimmarrja e palës së paditur është plotësisht e bazuar në prova dhe në ligj si përse i përket përcaktimit të kundërvajtjes administrative, ashtu edhe vlerës së dënimit me gjobë të vendosur nga inspektorët e organit tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier. Në vlerësim të kësaj gjykate, veprimtaria administrative e palës së paditur është në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*". Në nenin 54 të këtij ligji është parashikuar detyrimi i tatimpaguesve për instalimin e pajisjeve fiskale dhe lëshimin e kuponit tatimor. Konkretisht kjo dispozitë parashikon se:

*"1. Kuponit tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.*

*2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimore, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.*

*3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.*

*4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.”*

Kurse në nenin 122 të këtij ligji është përcaktuar se:

*“Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:*

*b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:*

*i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;*

*.....;”*

Në interpretim të këtyre dispozitave konstatohet se moslëshimi i kuponit tatimor nga subjekti tatimpagues përbën kundravajtje administrative dhe dënohet sipas parashikimeve të dispozitës së sipërcituar. Në analizë të akteve e provave shkresore të ndodhura në dosje e që iu nënshtruan debatit gjyqësor, kjo Gjykatë arrin në konkluzionin se pretendimet e palës paditëse lidhur me kundërligjshmërinë e akteve administrative Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.5814 prot., datë 20.04.2012 dhe vendimit nr.8736/3 prot, datë 18.05.2012 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, janë të pabazuara në ligj dhe në prova. Po ashtu, pala paditëse, pavarësisht detyrimit që kishte bazuar në nenin 108, pika 5 të ligjit për procedurat tatimore ku është përcaktuar se: *“Barra e provës, për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë, bie mbi tatimpaguesin”* dhe nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile ku është parashikuar se: *“Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.”*, nuk arriti të provojë pretendimet e tij lidhur me kundërligjshmërinë e vendimmarrjes së palës së paditur, e për këtë arsye këto pretendime do të mbeten në kuadrin e pretendimeve të paprovuara.

Në rastin objekt gjykimi, për sa kohë që rezultoi e provuar në gjykim se nga ana e subjektit tatimpagues Edmond Rrapaj, palë paditëse në gjykim, nuk ishte instaluar e vënë në përdorim kasa fiskale e po ashtu nuk janë lëshuar kupona tatimore në zbatim të detyrimeve ligjore të evidentuara si më sipër, me të drejtë pala e paditur ka disponuar për dënimin e këtij subjekti me gjobë në masën 100.000 lekë. Kjo masë administrative e vendosur nga pala e paditur vlerësohet të jetë në përputhje me parashikimet e bëra në dispozitën e sipërcituar, për sa kohë që është vetë ligji i posacëm që autorizon organet tatimore për të marrë masat përkatëse, në rast të konstatimit të mospërbushjes nga ana e tatimpaguesve të detyrimit për t'u pajisur me kasa fiskale.

Bazuar në konsideratat e mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se akti administrativ objekt gjykimi, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 5814 prot., datë 20.04.2012, përbën një akt administrativ të nxjerrë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore, e për këtë arsye pretendimi paditësit për anullimin e tij vlerësohet i pabazuar. Për rrjedhojë, edhe akti administrativ që ka lënë në fuqi Njoftim Vlerësimin për Detyrimin Tatimor, vendimi nr. 8736/3 prot, datë 18.05.2012 i Drejtorisë së Apelit Tatimor, konsiderohet akt administrativ i vlefshëm në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, e për këtë arsye duhet të lihet në fuqi.

Edhe procedura e zhvillimit të këtij gjykimi rezulton të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Nuk konstatohen shkelje si në procedurën e zhvillimit të gjykimit edhe në procedurën e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë. Për të gjitha sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit vlerëson tërësisht të pabazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur dhe duke qënë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në analizë të plotë e të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit, referuar nenit 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012, kjo gjykatë vlerëson se duhet të lihet në fuqi.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, gërma "b" të ligjit nr.49/2012 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative*".

**VENDOSI**

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 5358 (1752), datë 20.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**Tiranë më 04.02.2016**

**ANËTARE**

**Alkelina GAZIDEDJA**  
dv

**ANËTAR**

**Artur MALAJ**  
dv

**KRYESUESE**

**Lindita SINANAJ**  
dv

**Vertetohet njësia me origjinalin**

*Kancelosi*  
*Leonard Stecay*  
*Stecay*